

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " GK MARITIME "**

Në Durrës, sot në datën **27/TETOR/ 2021**( Dymijë e njëzet e një ), ne :

1. **Ened Kosova**, atesia Gezim, i datëlindjes 22/10/1983, lindur në Durres, dhe banuese ne Durres: Rruga Karl Topia nr 4, pajisur me leternjoftim Nr. 032836688, lëshuar në datën 19/06/2015, nr. Personal I 31022014O, madhore, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar.

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 " Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " ( i azhornuar ), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "... etj.

Themelojme shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "**GK MARITIME**" sh.p.k.

**Selia e shoqërisë** është në Durrës, në adresën : Lagja Nr. 4, Rruga Ramazan Jella, Apartamenti radha 19, Zona 3/93/219

Objekti i shoqërisë është : Aktivitet te agjensise detare dhe spacionere. Aktivitet te spontimit te mallrave ,aktiviteteteve te tjera qe lidhen me veprimtarine detare. Aktivitet Shipchandler furnizim anijeve me mallra ushqimore industrial. Aktivitet te agjensise turistike si dhe te transportit nderkombetar te mallrave te çdo lloji dhe pasajjerave me mjetet e veta dhe ato ne rruge tokesore,detare dhe ajrore.

**Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është pa afat.**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 ( Një mijë ) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, dhe zotërohet :**

- 1 kuote, me vlerë 1000 ( nje mijë ) Leke, me 100 % pjesemarrje nga ortaku themelues Ened Kosova

Shoqëria do te shtrije aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksonin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anullohen ( në rast se janë celur ) Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

**Administrimi i shoqërisë**

**Administrator i shoqërisë emërohet Z. Ened Kosova**, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistonjë shkaqe të ligjshme që mud ta shpallin të pavlefshme.

**Afati i emërimit të administratorit** është **pesë vjet**. Administratori emërohet sot në datën 27/Tetor/2021 dhe përfundon në datën 27/Tetor/ 2026. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ( Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare )

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transkaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i Përgjithshëm i emëruar kryen

veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e Kapitalit Themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitive të Kodit Civil. Ortaku gjëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazën e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, në gjuhën shqipe, me përbajtje e vlera nga ne në çdo faqe.

#### ORTAKU THEMELUES

ENED KOSOVA

A handwritten signature in black ink, appearing to read "NED KOSOVA".